REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LUSHNJE

Nr. 542 Prot. Lushnje më, 14/01/2026

R E L A C I O N

KËSHILLIT BASHKIAK

"MBI SHPËRBLIMIN E SPORTISTIT LAURENC HASKO DHE TRAJNERIT TË TIJ AMARILDO GJYLA"

Të nderuar zotërinj këshilltarë!

Peshëngritja është një sporti i bazuar në forcën fizike të personit që e ushtron. Ushtrohet me ngritjen e peshave të rënda,e cila ndahet në kategori peshash dhe mbështetur edhe në moshat e sportistëve. Ky sport cilësohet edhe si një nga sportet më të vjetra në botë.

Në Lushnje është hapur për herë të parë ekipi i peshëngritjes në vitin 1985 me sportistë të grupit U-14. Ndër vite ekipi i peshëngritjes ka arritur të marrë kupa të ndryshme si në rang kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar.

Pranë Bashkisë Lushnje ka ardhur kërkesa nga Federata Shqiptare e Peshëngritjes, për shpërblimin e sportistit Laurenc Hasko,shpallur kampion në Kampionatin Kombëtar për të Rritur në ambientet e Pallatit të Sportit *"Feti Borova"* në Tiranë. Ai arriti rezutate të rëndësishme në kategorinë 65 kg dhe medalje ari në kategoritë: *stili i shkëputjes 100 kg, stili i shtytjes 125 kg dhe totali i dygarëshit 225 kg*, me trajner z. Amarildo Gjyla.

Fondi për shpërblimin e sportistit që ka fituar vendin e parë në Kampionatin Kombëtar për të Rritur,Laurenc Hasko në kategorinë 65 kg dhe medalje ari në kategoritë: *stili i shkëputjes 100 kg, stili i shtytjes 125 kg dhe totali i dygarëshit 225 kg*, është *100 000 (njëqind mijë) lekë,* me trajner z. Amarildo Gjyla që do të shkojnë për shpërblimin e dhe në masën 40% të vlerës që përfiton sportisti *40,000 (dyzetmijë) lekë.*

Propozojmë miratimin e projekt-vendimit bashkalidhur.

Ju faleminderit!

KRYETAR I BASHKISË

Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJE

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LUSHNJE

Nr. 542/1 prot.

Lushnje, më 14/01/2026

PROJEKT-VENDIM

NR. 07 DATË 14 / 01 / 2026

"MBI SHPËRBLIMIN E SPORTISTIT LAURENC HASKO DHE TRAJNERIT TË TIJ AMARILDO GJYLA"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____/____/2026, pasi analizoi relacionin e paraqitur nga Kryetarja e Bashkisë "Mbi shpërblimin e sportistit Laurenc Hasko dhe trajnerit të saj Amarildo Gjyla", si dhe mbeshtetur ne ligjin nr. 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"* i ndryshuar, neni 25 pika 1,neni 54 germa "n" dhe V.K.M. Nr. 789 datë 15.12.2021 *"Për kriteret, mënyrën e shpërblimint dhe trajtimin e sportistëve, që përfitojnë statusin e nivelit të lartë dhe trajnerëve të tyre,i përditësuar"* pikat 4, 7 dhe 15 dhe neni 39 pika 2 i ligjit nr 79/2017 "Për Sportin,"i ndryshuar,

PROPOZOJMË:

1. Të miratojë shpërblimin me vlerë prej *100 000 (njëqind mijë)* lekë për sportistin Laurenc Hasko dhe në masën 40% të vlerës që përfiton sportisti 40 000 *(dyzet mijë)* lekë për trajnerin Amarildo Gjyla.
2. Në Aparatin e Bashkisë do të pakësohet Fondi Rezervë *(me kod 00-01-AF129-604-V491AAA)* në vlerën *140,000 lekë* dhe shtohen në Qëndrën e Kulturës dhe Klubi i Shumësporteve, Programi *"Disiplinat e ndryshme sportivve të mbështetura" (me kod 00-01-AE129-602-V813AAB)* për 140,000 lekë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financë-Buxhetit dhe Qendra Kulturore dhe Klubi Shumësportit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ***(dhjetë)*** ditë pas shpalljes.

DREJTOR I Q.K.K.S.

Brizida Dervishi

DREJTORIA JURIDIKE

Bedri Hida

KRYETAR I BASHKISË
Eriselda Sefa

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com